# REPUBLIKA E KOSOVËS
## KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
**Komiteti për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm**
**Nr.01-060/01-20553/26 datë: 21.09.2026**

**Npi – 01/265 datë: 23.09.2026**

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, Komiteti për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, në mbledhjen e mbajtur më: 23.09.2026, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
**P R O C E S V E R B A L**

I MBLEDHJES -V- TË KOMITETIT PËR AMBIENT, SHËRBIME PUBLIKE DHE URBANIZËM
E mbajtur më datën: 23.09.2026 (e merkurë) në ora 10:00h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesia e Komitetit, znj.Egzona Selmani dhe anëtarët e Komitetit: znj.Uskana Deliu, z.Atdhe Isufi, z.Bajram Hajrizi dhe z.Faik Ramadani. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit ka marrë pjesë edhe: Procesmbajtëse znj.Agnesa Ademaj. Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit, znj.Egzona Selmani, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstratkt-Procesverbalit të mbajtur nga mbledhja e kaluar më 28.08.2026,
2. Konstatimi i vazhdimit të Mbledhjes së IV, e shtyrë nga data 28.08.2026,
3. Informatë nga DPUKGJ lidhur me rishikimin e Planit Zhvillimor Komunal, planet rregulluese dhe menaxhimin e ndërtimeve të larta,
4. Raporti i Inspektoratit të Ndërtimit për sigurinë e objekteve dhe inspektimet e realizuara,
5. Të ndryshme (propozime dhe planifikimi i vizitave të punës së KASHPU-së).

**Kryesuesja, znj.Egzona Selmani**: Përshëndetje! Dëshiroj të bëj verifikimin e anëtarëve të pranishëm. Janë të pranishëm pesë anëtarë. (Lexon rendin e ditës.) A ka ndonjë propozim për ndryshimin e rendit të ditës apo ndonjë ndryshim tjetër? Meqenëse më 07.09.2026 i kam dërguar e-mail z. Bardhyl Rushitit, mirëpo ai nuk ma ka konfirmuar pjesëmarrjen. Po ashtu, nuk kam arritur të kontaktoj as z. Arben Topallin.
**z.Bajram Hajrizi:** Unë propozoj që pikat 3 dhe 4 të shtyhen dhe të hiqen nga rendi i ditës, për shkak se nuk janë të pranishëm as drejtori dhe as përfaqësuesi i Inspektoratit. Mirëpo, më 29.09.2026 e kemi mbledhjen e Kuvendit dhe aty do të reagojmë ne, katër anëtarët e Kuvendit që jemi përfaqësues. Besoj se ata do të marrin pjesë në atë mbledhje. Meqenëse nuk po marrin pjesë në mbledhjet tona, nëse këtë çështje e konsiderojnë jo serioze, atëherë duhet të na tregojnë arsyet pse nuk po marrin pjesë dhe pse nuk po u përgjigjen ftesave të Komitetit. Nëse shohim se vazhdojnë të mos marrin pjesë, zyrat janë të hapura dhe mund të shkojmë edhe atje.
**z.Atdhe Isufi:** Ata duhet të dalin publikisht dhe të na tregojnë arsyet pse nuk po marrin pjesë në mbledhjet e komiteteve.

**z.Bajram Hajrizi:** Unë e marr përsipër që në mbledhjen e Kuvendit, më 29.09.2026, t'i rekomandoj Kuvendit që të kërkojë sqarime lidhur me arsyet pse këta përfaqësues nuk po marrin pjesë në mbledhjet e KASHPU-së. Gjithashtu, duhet të na i bëjnë të ditura arsyet e mospjesëmarrjes së tyre.
**Kryesuesja, znj. Egzona Selmani:** Po e hedh në votim rendin e ditës, ashtu siç është propozuar fillimisht. Kush është "për"?
***Komiteti për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, me 0 vota "Për" dhe 4 vota "Kundër", nuk e miratoi rendin e ditës ashtu siç është propozuar.**
Me propozimin e anëtarëve për ndryshimin e rendit të ditës, pika 3, "Informata nga DPUKGJ lidhur me rishikimin e Planit Zhvillimor Komunal, planet rregulluese dhe menaxhimin e ndërtimeve të larta", si dhe pika 4, "Raporti i Inspektoratit të Ndërtimit për sigurinë e objekteve dhe inspektimet e realizuara", hiqen nga rendi i ditës dhe shtyhen për mbledhjen e radhës. Kush është "për" propozimin për ndryshimin e rendit të ditës?
***Komiteti për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, miratoi unanimisht rendin e ditës me ndryshime si në vijim:**

## REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstratkt-Procesverbalit të mbajtur nga mbledhja e kaluar më 28.08.2026,
2. Të ndryshme (propozime dhe planifikimi i vizitave të punës së KASHPU-së).

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstratkt-Procesverbalit të mbajtur nga mbledhja e kaluar më 28.08.2026,

**Kryesuesja, znj. Egzona Selmani:**Hapi diskutimin për këtë pikë. A ka ndonjë vërejtje? Meqenëse nuk ka diskutime të tjera, e hudh në votim Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 28.08.2026.
***Komiteti për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 28.08.2026.**

Pika 2

Të ndryshme (propozime dhe planifikimi i vizitave të punës së KASHPU-së).

**Kryesuesja, znj. Egzona Selmani:** E hapi diskutimin për këtë pikë. Desha t'ju pyes nëse dëshironi t'i ndajmë detyrat lidhur me vizitat, përkatësisht të përcaktojmë se ku dhe kush do t'i realizojë ato. Mendoj se është mirë t'i japim secilit përgjegjësi të caktuara dhe t'u përmbahemi detyrave.
**z. Faik Ramadani:** Desha të pyes lidhur me pikat që i larguam. Ne nuk morëm rekomandim dhe as përgjigje për to. Pajtohem me këtë, por a nuk do të ishte më mirë që ne, si KASHPU, ta konsideronim si papërgjegjësi mospjesëmarrjen e të ftuarve, pasi nuk kanë kthyer as përgjigje me shkrim? Ne, si grup, jemi të hendikepuar nga mungesa e tyre, sepse nuk kemi informata të mjaftueshme. A do të mundnim ne, si KASHPU, të konstatonim se jemi të hendikepuar nga mungesa e inspektorëve dhe e përfaqësuesve të drejtorive?
**z. Bajram Hajrizi:** Mirëpo, këta asnjëherë, që nga mbledhja e katërt, nuk janë përgjigjur dhe, për këtë arsye, po them se duhet të diskutojmë. Ne, si anëtarë të Kuvendit, e ngremë zërin dhe kërkojmë përgjegjësi nga personat që është dashur të vijnë, por nuk kanë ardhur. Unë i njoh drejtorët dhe ata duhet të na japin një përgjigje se pse po na injorojnë dhe ku qëndron problemi.
**Kryesuesja, znj. Egzona Selmani:** Në mbledhjen e kaluar ka qenë rekomandim që të jetë i ftuar edhe zyrtari i shërbimit të zjarrfikësve. As ai nuk ka qenë i pranishëm, edhe pse e kam telefonuar dhe i kam dërguar e-mail, por nuk është lajmëruar.

**z. Atdhe Isufi:** Sa u përket vizitave, propozoj që të jemi së paku dy persona dhe të mos e lëmë një person të vetëm, sepse ka vizita ku nuk e njeh as terrenin dhe as personat përgjegjës. Kështu punohet më lehtë kur jemi dy persona.

**Kryesuesja, znj. Egzona Selmani:** Po, unë do ta caktoja një datë dhe pastaj do të konsultoheshim se kush do të shkonte në vizitë. Mirëpo, mbetet te ju ta përcaktoni mënyrën që e shihni më të arsyeshme.

**z. Atdhe Isufi:** Unë do ta propozoja shkollën e Vojnocit, ku kemi shkuar dhe kemi takuar personat përgjegjës.

**z. Faik Ramadani:** Ndërsa unë do ta propozoja shkollën e Pjetërshticës. Aty do të mund ta takoja drejtorin dhe të diskutonim për këto çështje, të cilat ua kam shpjeguar. Mund të konstatoj se shkolla e Pjetërshticës është e mirëmbajtur, me përjashtim të oborrit, i cili ka nevojë për rregullim. Ambienti i brendshëm i shkollës është shumë i mirë dhe mund t'ju siguroj se shkolla e Pjetërshticës është në gjendje të mirë. Ka mundësi të përmirësohet edhe më shumë, por kemi biseduar edhe me drejtorin, i cili do t'i ketë parasysh këto çështje.

**Kryesuesja, znj. Egzona Selmani:** Mirëpo, çështja tjetër është se nuk e di sa na takon neve, por shkolla e Petrovës tash e dy vjet e zhvillon mësimin me orë prej 25 minutash. Megjithatë, kjo çështje i takon më shumë Komitetit për Arsim. Atëherë, te pika 5, e kam lexuar planin që e kemi për muajin shtator.

**z. Bajram Hajrizi:** Mund të shkoj për vizitë në shkollën e Reçakut dhe në shkollat e tjera, ku të dëshironi. Mund të vendosim përsëri, mirëpo besoj se mund t'i përfundoj vizitat në tri ose katër shkolla brenda një dite.

**Kryesuesja, znj. Egzona Selmani:** Mua më intereson se kur do të zgjidhet çështja e shkollës në Petrovë, në mënyrë që mësimi të zhvillohet me orar të plotë, sepse nuk më pëlqen mënyra se si po zhvillohet mësimi me orë prej 25 minutash. Gjithashtu, desha të shtoj se për muajt shtator dhe tetor kemi planifikuar shqyrtimin e informacionit nga DSHP-ja. A nuk do të ishte më mirë që pika e tretë, e paraparë për muajin shtator, të shtyhej për muajin tetor? Në rregull, atëherë kjo pikë shtyhet për muajin tetor.

**Kryesuesja, znj.Egzona Selmani:** Ju falënderoj për diskutimet. Meqenëse nuk ka diskutime të tjera, e përfundoj mbledhjen në orën 10:46.

Procesmbajtëse
Agnesa Ademaj

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES-OPŠTINA ŠTIMLJE
SHTIME-ŠTIMLJE
v.v.

Kryesuesja e Komitetit
Egzona Selmani